



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH .nr.579/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Goran Milenković –Kryetar , panelist individual ,duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE “Lurn&Pro&Co Group” - Fushë Kosovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “Megi Bau GmbH” sh.p.k , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në KRU Prishtina sh.a zona Shtime”, me nr. të prokurimit: 70433736-20-2185-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kompania Ujësjetllësi Rajonal "Prishtina"sh.a., më datën 17.09.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit OE “Lurn&Pro&Co Group” - Fushë Kosovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në KRU Prishtina sh.a zona Shtime, me nr. të prokurimit: 70433736-20-2185-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kompania Ujësjetllësi Rajonal "Prishtina"sh.a.

II.ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në KRU Prishtina sh.a zona Shtime”, me nr. të prokurimit: 70433736-20-2185-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kompania Ujësjetllësi Rajonal "Prishtina"sh.a. dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik OE "Lurn&Pro&Co Group" - Fushë Kosovë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i depozitës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE "Lurn&Pro&Co Group" - Fushë Kosovë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 19.08.2020, me nr. 579/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : "Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në KRU Prishtina sh.a zona Shtime", me nr. të prokurimit: 70433736-20-2185-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kompania Ujësjiellësi Rajonal "Prishtina" sh.a.

- Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.08.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 03.09.2020, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pretendimi nr.1, Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues është njoftuar nga AK-ja, si tenderues i pasuksesshëm dhe i njëjti në ankesën e tij ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e të rekomanduarit për kontratë.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, se i rekomanduari për kontratë në listën e stafit e ka prezantuar si menaxher të projektit Bekim Rexhepin – Inxhinier i Ndërtimtarisë, ku sipas OE ankues i njëjti inxhinier është punëtorë i kompanisë së tij, dhe për të cilin deklaron se posedon dëshmi të trustit pensional dhe në fund pretendon se OE i rekomanduar për kontratë i ka përdorur dokumentet e inxhinierit të lartpërmendur pa autorizim.

Eksperti shqyrtues, lidhur me këtë pretendim sqaron se autoriteti kontraktues, pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim të OE ankues i cili e ka pasur të njëjtin pretendim edhe në kërkesën për rishqyrtim, sqaron se me datën: 11.08.2020, AK-ja, ka bërë verifikimin e pretendimit të lartpërmendur, ku përmes email-it, ka kërkuar

sqarim te pozicionit te inxhinierit të ndërtimtarisë, Bekim Rexhepit, i cili poashtu përmes email-it ne përgjigje të kërkesës së AK-se, është deklaruar se, citat: “Ju njoftoj se unë Bekim Rexhepi punoj ne operatorin ekonomik Megi Bau Gmbh Sh.p.k”. Prandaj, pretendimi i OE ankues se, i rekomanduari për kontratë i ka përdorur dokumentet e inxhinierit te lartpërmendur pa autorizim është i paqëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se i rekomanduari për kontrate, ka ofruar diplomën Bachelor të Gjeodezisë, prandaj sipas OE ankues i rekomanduari për kontrate nuk e ka plotësuar kërkesën e AK-se lidhur me inxhinierin e Gjeodezisë.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne kërkesën e DT-se, e cituar ne piken 3 të këtij raporti, vlerëson se pretendimi është i paqëndrueshëm për faktin se kërkesë e DT-se ka qene: Një Inxhinier të gjeodezisë, sistemi i para-Bolonjës ose Bolonjës, dhe nuk është cekur grada Bachelor apo Master.

Sa i përket pretendimit te OE ankues, se inxhinieri i Hidroteknikes, ne deklaratën e tij nuk e ka cekur pozicionin për çfarë është i angazhuar dhe se te njëjtën deklaratë AK-ja, e ka kërkuar gjatë vlerësimit te ofertave.

Eksperti shqyrtues, sqaron se pozicioni i inxhinierit te lartpërmendur, është i cekur ne listën e stafit profesional, ne te cilën thuhet se i njëjti ka pozicionin e Inxhinierit te punishtes dhe njëherit është i paqëndrueshëm pretendimi se janë kërkuar sqarime shtese për faktin se sqarime lidhur me dëshmitë e lartpërmendura janë te lejuara konform nenit 72 te LPP-se.

OE ankues, pretendon se i rekomanduari për kontrate nuk e plotëson kërkesën e FDT-se, lidhur me pajisjet e kërkuara për realizimin e projektit, konkretisht pretendon se i mungojnë dëshmitë për 2 ekskavator me zinxhir, për një Damper, për një prerëse asfalti, për një ngjeshës të Tokës dhe për një kamion nga gjithsej 3 te kërkuar ne DT.

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimin e lartshënuar ka vërejtur se OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontrate nuk e ka numrin e nevojshëm te pajisjeve për realizimin e projektit. Eksperti shqyrtues, në dosje të tenderit sqaron se nuk ka kërkesë për numër të caktuar siç pretendon OE ankues. Në dosje të tenderit ne kërkesën numër 4 te pikës 9.1 te FDT-se, ne asnjë pjese nuk thuhet kërkohet numër i caktuar i pajisjeve. Prandaj ky pretendim është i paqëndrueshëm.

Sa i përket pretendimit te OE ankues se i rekomanduari për kontratë, nuk posedon kontrata dhe referenca sipas kërkesës se DT-se, duke pretenduar se ne FDT janë kërkuar se paku 3 kontrata të suksesshme në lëmine e ngjashme.

Eksperti shqyrtues, vlerëson si të paqëndrueshëm këtë pretendim për faktin se duke u bazuar në kërkesën e

cituar ne pikën 3 te këtij raporti, lidhur me kontratat dhe referencat eksperti shqyrtues nuk ka vërejtur se janë kërkuar tri kontrata dhe referenca siç pretendon OE ankues. Ndërsa sa i përket kontratës se dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontrate dhe OE Bechtel Enka, me te njëjtën kontrate eksperti shqyrtues vlerëson se e ka plotësuar kërkesën ne dosjes se tenderit për faktin se ne kërkesë thuhet: "...se paku një kontrate pune te ngjashme..." dhe jo 3 kontrata siç pretendon OE ankues.

Sa i përket pretendimit se OE i rekomanduar për kontrate Megi Bau do të duhej ta dorëzonte vërtetimin e ATK-se, përpara vendimit për dhënie të kontratës dhe me këtë rast pretendon se AK-ja, ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-se.

Eksperti shqyrtues, sqaron se vendimi për dhënie të kontratës mban datën: 06.08.2020, ndërsa dy dëshmitë e përcaktuara sipas pikës 6.4 te FTD-se, janë kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me datën: 03.08.2020. Andaj, eksperti shqyrtues, vlerëson si të paqëndrueshëm këtë pretendim.

Mendimi i ekspertit shqyrtues : Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi.

Autoriteti Kontraktues, me datën 03.09.2020 me anë të parashtresës, e ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datën 04.09.2020 me anë të parashtresës, e ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues si me poshtë:

Ju njoftojmë se ne si kompani nuk pajtohemi me vendimin e ekspertit lidhur me lenden; Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrjetit te kanalizimit ne KRU Prishtina sh.a _zona Shtime, Nr. 70433736-20-2185-5-2-1.

Ne kemi ofruar dëshmi te mjaftueshme se Operatori Ekonomik i propozuar për fitues " MegiBau GMBH , nuk i plotëson kërkesat e kërkuara ne FDT. Andaj ju lusim qe te rivlerësohet edhe një here nga eksperti pika Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale- Kërkesa 3. Një Inxhinier te gjeodezisë, sistemi i para-Bolonjes ose Bolonjes;(ju lutem qe te merrni informata me te hollësishme se çka nënkupton Inxhinier i gjeodezisë e qka nënkupton bachelor i gjeodezise) sipas vlerësimit tone kompania MegiBau GMBH ish dashtë te ofroj inxhinjer te diplomuar te gjeodezisë (PARA BOLONJES) apo Master te Gjeodezise (Bolonjes). Përveç kësaj pike, nuk plotëson as kriteret minimale te makinerisë se kerkuara ne FTD: Nuk ka asnjë reference për pune te natyrës se kërkuar (PUNIME TE KANALIZIMIT). Ju lusim qe kërkesa jone te merret parasysh , ne te kundërtën do te marrim hapa te tjerë sipas Ligjit te Prokurimit Publik.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 17.09.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues/technik të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues/technik deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës, dhe se OE ankues është njoftuar nga AK-ja, si tenderues i pasuksesshëm dhe i njëjti në ankesën e tij ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e të rekomanduarit për kontratë.

Lidhur me pretendimin e ankuesit, se OE i rekomanduari për kontratë në listën e stafit e ka prezantuar si menaxher të projektit Bekim Rexhepin – Inxhinier i Ndërtimtarisë, ku sipas OE ankues i njëjti inxhinier është punëtorë i kompanisë së tij, dhe për të cilin deklaron se posedon dëshmi të trustit pensional dhe në fund pretendon se OE i rekomanduar për kontratë i ka përdorur dokumentet e inxhinierit të lartpërmendur pa autorizim.

Paneli shqyrtues konform Eksperti shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues, pas pranimi të kërkesës për rishqyrtim të OE ankues i cili e ka pasur të njëjtin pretendim edhe në kërkesën për rishqyrtim, sqaron se me datën: 11.08.2020, AK-ja, ka bërë verifikimin e pretendimit të lartpërmendur, ku përmes email-it, ka kërkuar sqarim të pozicionit të inxhinierit të ndërtimtarisë, Bekim Rexhepit, i cili poashtu përmes email-it në përgjigje të kërkesës së AK-se, është deklaruar se, citat: “Ju njoftoj se unë Bekim Rexhepi punoj në operatorin ekonomik Megi Bau GmbH Sh.p.k”. Prandaj, pretendimi i OE ankues se, i rekomanduari për kontratë i ka përdorur dokumentet e inxhinierit të lartpërmendur pa autorizim është i paqëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se i rekomanduari për kontratë, ka ofruar diplomën Bachelor të Gjeodezisë, prandaj sipas OE ankues i rekomanduari për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën e AK-se lidhur me inxhinierin e Gjeodezisë.

Paneli shqyrtues konstaton se AK në DT, ka kërkuar Një Inxhinier të gjeodezisë, sistemi i para-Bolonjës ose Bolonjës, AK me rastin e rivlerësimit të kërkoj sqarime në pajtim me nenin 59 dhe 72 të LPP-së dhe të vërtetoj se OE në fjalë a ka plotësuar kërkesën e AK-së, për piken e cekur si më lart.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se inxhinieri i Hidroteknikes, ne deklaraten e tij nuk e ka cekur pozicionin për çfarë është i angazhuar dhe se te njëjtën deklaratë AK-ja, e ka kërkuar gjatë vlerësimit te ofertave.

Paneli shqyrtues konform Eksperti shqyrtues, sqaron se pozicioni i inxhinierit te lartpërmendur, është i cekur ne listën e stafit profesional, ne te cilën thuhet se i njëjti ka pozicionin e Inxhinierit te punishtes dhe njëherit është i paqëndrueshëm pretendimi se janë kërkuar sqarime shtese për faktin se sqarime lidhur me dëshmitë e lartpërmendura janë te lejuara konform nenit 72 te LPP-se.

Lidhur me pretendimin e ankuesit, se i rekomanduari për kontrate nuk e plotëson kërkesën e FDT-se, lidhur me pajisjet e kërkuara për realizimin e projektit, konkretisht pretendon se i mungojnë dëshmitë për 2 ekskavator me zinxhir, për një Damper, për një prerëse asfalti, për një ngjeshës të Tokës dhe për një kamion nga gjithsej 3 te kërkuar ne DT.

Paneli shqyrtues konform Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimin e lartshënuar konstaton se OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontrate nuk e ka numrin e nevojshëm te pajisjeve për realizimin e projektit. Në dosje të tenderit nuk ka kërkesë për numër të caktuar siç pretendon OE ankues. Në dosje të tenderit ne kërkesën numër 4 te pikës 9.1 te FDT-se, ne asnjë pjese nuk thuhet kërkohet numër i caktuar i pajisjeve. Prandaj ky pretendim është i paqëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e ankuesit, se i rekomanduari për kontratë, nuk posedon kontrata dhe referenca sipas kërkesës se DT-se, duke pretenduar se ne FDT janë kërkuar se paku 3 kontrata të suksesshme në lëmine e ngjashme.

Paneli shqyrtues konstaton se me rastin e rivlerësimit AK ne pajtim me nenin 59 dhe 72 te LPP-se te kërkoj informata shtese lidhur me dëshmitë e ofruar për piken e lartcekur dhe te vërtetoj se OE i rekomanduar për dhënie te kontratës plotëson apo jo kërkesën e AK-se te cekur si me lart.

Lidhur me pretendimin e ankuesit, se OE i rekomanduar për kontrate Megi Bau do të duhej ta dorëzonte vërtetimin e ATK-se, përpara vendimit për dhënie të kontratës dhe me këtë rast pretendon se AK-ja, ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-se.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues, sqaron se vendimi për dhënie të kontratës mban datën: 06.08.2020, ndërsa dy dëshmitë e përcaktuara sipas pikës 6.4 te FTD-se, janë kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me datën: 03.08.2020. Andaj ky pretendim është i paqëndrueshëm.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave për pikat e cekura si më lart të kërkoj sqarime shtese nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës në pajtim me nenin 59 dhe 72 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
z. Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Kompania Ujësjellësi Rajonal "Prishtina" sh.a.
- 1x1 OE ankues – OE "Lurn&Pro&Co Group" - Fushë Kosovë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.